



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .04.2024

**MBLEDHJA Nr. 12,**  
**Datë 29.04.2024, ora 11:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 29.04.2024, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 12 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 27.03.2024, datë 29.03.2024 dhe datë 15.04.2024.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “TEODORI” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. nr. 313, datë 06.11.2023 dhe miratimin e kërkesës së shoqërisë “SELCA ENERGJI” shpk për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike.
4. Mbi heqjen e pezullimit të vendosur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 32, datë 27.03.2024 dhe licencimin e shoqërisë “DRINI BULQIZE” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARE NË DETYRË**  
**Erjola SADUSHI**